



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.3154/3 prot.,

Datë 20.12.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK” SH.A në procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-88286-11-20-2023, me objekt, “*Shërbim për siguracion automjesh TPL + kasko*” me fond limit 4,288,171 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

**Ankimues:** Operatori Ekonomik “ATLANTIK” SH.A me NIPT: K11807008V.  
Adresa: *Rruga “Themistokli Gërmenji”, 3/1, Tiranë*

**Autoriteti Kontraktor:** Albpetrol sh.a  
Adresa: *Selia Rruga Fier – Patos, km 7*

Në datën 19.12.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë shkresore ankesa me nr. 3154, protokolluar me datë 19.12.2023 e operatorit ekonomik “ATLANTIK” SH.A për procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-88286-11-20-2023, me objekt, “*Shërbim për siguracion automjesh TPL + kasko*” me fond limit 4,288,171 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK” SH.A.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “ATLANTIK” SH.A kundërshton me anë të ankesës me nr. 3154 prot., datë 19.12.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

### **Arsyet e skualifikimit:**

Për kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik të Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, ka depozituar:

o Listepagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit që provon se vlerësuesi i demëve është i punësuar pranë operatorit ekonomik, kjo në kundërshtim me kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, të DST ku kerkohen:

- Licenca si vlerësues demesh
- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit që provon se vlerësuesi i demëve është i punësuar pranë operatorit ekonomik.

Nderkohe në sistemin SPE dhe në dokumentacionin e paraqitur në formë shkresore është rezultuar dokumentacioni i vlerësuesit të demëve z.Hetem Xhameni ku mungojnë listepagesat e tre muajve të fundit dhe kontrata individuale e punës lidhur me kompaninë.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 20.12.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**